
MATHEMATIC CURRICULUM CHANGE AND ELEMENTARY SCHOOL TEACHERS' OPINION

Teuta Iljazi

State University of Tetova- Tetovo, Republic of Macedonia

teuta.iljazi@unite.edu.mk

Abstract: Elementary schools are of great importance during the education of the children. The professional and pedagogical preparation of teachers is also of great importance which results are successful students and conscious citizens. XXI century with inclusive schools, ICT knowledge is complemented by mathematical knowledge applicable to everyday life. Students must learn mathematics with understanding, actively building new knowledge from experience and prior knowledge. In R.Macedonia as well as in neighboring states in the last decade, changes have been made to the elementary school Mathematic curriculum in order to increase mathematical knowledge and skills. This shift not to all teachers is well received.

The aim of this study is to identify the causes of low success in the subject of Mathematics by the teachers' view. The data has been collected by questionnaires realized with teachers from different schools in R.Macedonia. The statistical processing of the questionnaires helps us conclude that the opinion of the teachers about the changes on the curricula of Mathematics does not depend on gender, age or teachers' experience .

Keywords: teacher, curriculum, Matematic teaching, inclusive schools.

NDRYSHIMI I KURRIKULËS SË LËNDËS SË MATEMATIKËS DHE OPINIONI I MËSUESVE TË SHKOLLËS FILLORE

Teuta Iljazi

Universiteti Shtetëror i Tetovës-Tetovë,Republika e Maqedonisë

teuta.iljazi@unite.edu.mk

Shkolla fillore ka një rëndësi të madhe gjatë arsimimit të një fëmije. Pregaditja profesionale, pregaditja pedagogjike e mësuesve është gjithashtu e një rëndësie të madhe, që rezulton me nxënës të suksesshën dhe qytetarë të ndërgjegjshëm. Shekulli XXI me shkollat inclusive, njohuri në TIK plotësohet edhe me njohuritë matematikore të zbatueshme në jetën e përditshme. Në R.Maqedonisë si dhe në disa shtete fqinje në dekadën e fundit janë bërë ndryshime në kurrikulën e lëndës së Matematikës të shkollës fillore që ka pasur për qëllim të rris dijen dhe shkathësitë matematike. Ky ndryshim nuk është mirëpritur nga të gjithë mësuesit.

Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i shkaqeve të suksesit të dobët në lëndën e matematikës duke kërkuar mendimin e mësuesve. Të dhënat janë mbledhur nga pyetëtori i realizuar me mësues nga disa shkolla fillore të R.Maqedonisë. Përpunimi statistikor i pyetësorit na sjell gjer në përfundimin se qëndrimi i mësuesve në lidhje me ndryshimet në kurrikulën e lëndës së matematikës nuk mvaret nga gjinia, moshë ose edhe përvoja e mësuesve.

Fjalët kyce; Mësuesi, kurrikula, mësimdhënia matematike, shkollat inkluzive.

1.HYRJA

Mësuesi është personi cili duke kryer detyrën e vetë ndihmon të tjerët të nxënë, të fitojnë përvoja të reja që të jenë të aftë këto njohuri ti zbatojnë në njohuritë dhe praktikat e reja (Musai.B, 2003). Me zhvillimin e shoqërisë , me zhvillimin e teknologjis dhe me shpërndarjen e shpejtë të informacionit mësuesi, mësimdhënia dhe të nxënë të pësuar ndryshime me qëllim ti plotësojë nevojat dhe zhvillimin e shoqërisë. Mësuesi është personi,i cili është profesionist dhe vendimmarrës. Ai është personi që planifikon dhe sjell vendime për mësimdhënien dhe të nxënët.. Mësuesi është personi, i cili respekton nxënësin, respekton mendimin e nxënësit dhe nxit të menduarit kreativ të tij. Mësuesi është largpamës, ai duhet ti njeh nxënësit dhe ti udhëheq mendimet e nxënësit që ato mendime ta shpiejnë nxënësin në rrugë të drejtë gjatë zgjidhjes së problemeve qoftë shkollore, qoftë ato të jetës së përditshme. Mësuesi gjithashtu është personi, i cili sëbashku me nxënësit i përjeton gëzimet, hidhërimet dhe sukseset e tyre.. Mësuesin e suksesshëm ta përkufizosh nuk është e lehtë, sepse shumë faktorë ndikojnë në suksesshmërinë e tij/saj, gjegjësisht në efektshmërinë e mësuesisë. Në vende të ndryshme, në kultura të ndryshme dhe në kohë të ndryshme mësuesi/sja i mire përshkruhet në mënyra të ndryshme. Aksoy.N (1998) në punimin e saj në lidhje me opinionin e studentëve për “Mësuesi i mire” duke shqyrtuar literaturën shprehet që Gudmundsdottir dhe Saabar (1991) kanë spieguar që në

Kinë mësuesi i mire është përshkruar si virtuoz i mire, sepse arti i tyre është mësimdhënia. Në Angli mësuesi i mire është supermen me kualitete personale të pritshme dhe komandë të shkathtësive pedagogjike. Në SHBA sipas po të njëjtit punim mësuesi i mire është artisti, arti i të cilit bazohet në dije dhe imagjinatë. Mësuesi i mire në Izrael është krijues i kombit, i cili është përgjegjës për transmetimin e dijes kulturore gjeneratave të reja. Nga ana tjetër në Norvegji mësuesi i mire është shikuar si interpretues dhe përkthyes i mire i tekstit. Nëse kërkohen karakteristikat e mësuesit të mire, atëherë mund të cekën disa dhe të thuhet se mësuesi i mire është bashkëpunues i mirë, është kreativ, i kujdesshëm, i vendosur, entuziast, adaptil, tolerant, i durueshëm, fleksibil, ndëgjues i mirë, i mirëinformuar, i motivuar, miqësor, i organizuar.

Matematika si shkencë trajtohet si shkencë e numrave, shkencë e formave, shkencë e hapsirës dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Duke u bazuar në simbolet dhe diagramet e saja ajo mund të trajtohet edhe si një gjuhë universale. Edukimi matematikë në vehte përfshin dijen, shkathtësitë dhe aktivitetet e nevojshme që i ndihmojnë fëmijës për të zhvilluar dhe kuptuar botën fizike dhe bashkëveprimin shoqëror. Matematika i jep fëmijës gjuhën dhe sistemin me të cilin fëmija do të përshkruajë, analizojë, spiegojë përvojën, do të parashikojë dhe do të zgjidh problemin me të cilin ballafaqohet. Matematika zhvillon ndjenjën për humulzim, rezonim dhe kreativitet. Edukimi matematikë ndikon që fëmija të ketë vetëbesim përgjatë mediumit matematikor. Matematika në vehte përfshin një tërësi dijes, shkathtësish dhe rregullash të cilat mund të përdoren për të ilustruar, demonstruar, spieguar, parashikuar dhe sjellur vendime për kuptimet si që janë numri, bashkësia, forma, hapsira, masa si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Gjuha e matematikës mundëson informata të organizohet, të përpunohet si dhe në anën tjetër edhe të komunikohet. Këto karakteristika të matematikës e bëjnë atë mjet mjaft të rëndësishëm si për fëmijët ashtu edhe për të rriturit.

Programi mësimor përmban përmbledhje të qëllimeve mësimore të lëndës mësimore të matematikës, ku në mënyrë të detajuar përshkruhet çka nxënësi duhet të jetë në gjendje të bëjë në çdo vit të arsimit fillor. Qëllimet mësimore sigurojnë strukturë për mësimdhënie dhe të mësuarit si dhe udhëzime për atë se cilat shkathtësi dhe dituri të nxënësit duhet të vërtetohen. Programi mësimor për matematikë është i ndarë në fusha (lëmi për të cilat programi mësimor ofron ndihmë dhe udhëzime duke përshkruar teknikat, shkathtësitë dhe zbatimin e diturive si dhe strategjitë në zgjidhjen e problemeve. Në kurrikulën e matematikës janë të përfshirë pjesa e bashkësisë së numrave, pjesa e algjebërës, pjesa e figurave në rrafsh dhe hapsirë, pjesa e matjeve dhe pjesa e të dhënave.

Në dhjetëvjetëshin e fundit në Republikën e Maqedonisë kurrikula tradicionale prezente në shkollat fillore pëson ndryshim dhe zëvendësohet me kurrikulën spirale. Tek kurrikula spirale materiali është i koncentruar në periudha më të shkurtëra dhe zhvillohet duke u përsëritur kohë pas kohe, me qëllim që materiali të zgjerohet dhe të kalojë në një shkallë më të lartë kompleksiteti. Ky lloj kurrikule dallon nga ai tradicional i cili zhvillohet në tërësi ose fusha të caktuara. Kurrikula spirale gjen zbatim tek shkollat progressive, të cilat janë shkolla që lëvizin, shkolla që ndryshojnë dhe shkolla që përshtaten në kohë. Ekzistojnë dallime ndërmjet shkollës tradicionale dhe shkollës progressive. Disa nga dallimet ndërmjet shkollës tradicionale ndaj asaj progressive është se shkolla progressive është pjesë e jetës, nxënësit janë pjesëmarrës aktiv, zgjidhës problemesh dhe planifikues. Mësuesit tek shkollat progressive janë facilitator dhe prijës të të menduarit. Gjithashtu sipas shkollave progressive prindërit janë mësuesit e parë dhe komuniteti paraqet një klasë të zgjeruar. Të nxënësit është spiral me qëllim të zgjerimit dhe thellimit të dijes. Dija tek shkollat progressive është konstruktuar nëpërmjet të lojës, përvojës dhe interaktivitetit shoqëror. Nga ana tjetër suksesi përcaktohet nëpërmjet të zbatuarit dhe bashkëpunimit. Programi është përcaktuar si mission, fillofi dhe qëllim për të kaluar në klasë më të lartë. Vlerësimi është etapar dhe ka formë të ndryshme⁴⁹

Mjetet mësimore janë nevojë e patjetërsueshme gjatë realizimit të kurrikulës spirale. Figurat e ndryshme gjeometrike, mjetet për matje të madhësive, kalkulatorët, kompjuterët, mjetet për të demonstruar dhe zgjidhur probleme nga jeta e përditshme janë elemente me të cilat bëhet e mundur edhe zhvillimi i shkathtësive dhe proceseve si që janë njohja dhe të kuptuarit, komunikimi, vizualizimi dhe modelimi, zbatimi, interpretimi, vlerësimi, vërtetimi dhe vendimmarrja.

Gjatë realizimit të kësaj kurrikule mësojtorja shëndrohet në laborator punues, sepse të nxënësit kryhet me anë të eksperimenteve duke realizuar situata nga jeta e përditshme. Në këtë lloj të nxënësve nxënësit punojnë, luajnë, provojnë, marrin vendime sëbashku që ka për rrjedhim bashkëpunimin dhe punën ekipore. Duke pasur parasysh që materiali realizohet në formën e një spiraleje dhe secila dije e re fitohet duke u bazuar në dijet, njohuritë paraprake gjë që mundëson lidhjen e dijes paraprake me atë aktualen. Kjo mënyrë mundëson që të kalohet nga më e thjeshta kah e përbërja dhe kompleksja, që nxit të menduarit, gjegjësisht zhvillon shkathtësitë e të menduarit.

⁴⁹ <http://www.wingraschool.org/who/progressive.htm>

2.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Ky studim është bazuar në pyetëtorin të realizuar me 114 mësues të ciklit të ulët nga shkollat e Tetovës, Gostivarit, Strugës, Nga ky numër 85 janë të gjinisë femërore. Nga numri i përgjithshëm i mësuesve 15 janë me përvojë pune më pak se 5 vite, ndërsa 38 mësues janë me përvojë pune ndërmjet 5 dhe 10 vite. Me përvojë pune prej 10 gjer 15 vite janë 20 mësues dhe me përvojë pune më shumë se 15 vite janë 42 mësues. Nga përgjigjet e kësaj pyetjeje mund të përfundojmë se mësuesit janë pothuajse të gjithë me përvojë. Prej gjithsejt 114 mësues pyetëtori është i realizuar me 52 mësues të cilët profesionin e ushtrojnë në shkolla urbane, ku dihet që kushtet në ato shkolla dallojnë nga kushtet në shkollat urbane. Gjithashtu duhet thënë se edhe nxënësit e shkollave rurale dallojnë, sepse ata rriten në kushte që dallojnë nga kushtet urbane, si bie fjala ngritjam arsimore e prindërve të tyre, kushtet socio-ekonomike dhe kulturore, si dhe vetë kushtet shkollore. Sipas pregaditjes profesionale 81 mësues kanë të kryer fakultetin pedagogjik drejtimi grup klasor dhe 7 me drejtimin parashkollor të kryer. Nga numri i përgjithshëm i mësuesve 18 janë pedagog profesional, ndërsa të tjerët janë me kualifikim jo adekuat. Procesi i arsimit vetë mësimdhënia pëson ndryshime, prandaj edhe mësuesit kanë nevojë për aftësim, që zakonisht i realizon Byroja për zhvillim të arsimit, organizatat e ndryshme ose edhe vet shkollat. Në pyetjen se a kanë ndjeku trajnime 82% e mësuesve janë përgjigjur pozitivisht. Kjo e dhënë është shprehëdhënëse për shkak të përfshirjes së madhe të mësuesve nëpër trajnime në lidhje me procesin e mësimdhënies

Lënda e matematikës shpesh konsiderohet si lëndë e vështirë, lëndë abstrakte, lëndë e pakuptimë ose lëndë të cilën nuk mund ta zotërojnë të gjithë njerëzit. Për ta bërë më të lehtë dhe të kuptueshme për nxënësit, mësuesit përdorin mjete mësimore të ndryshme si që janë modelet e ndryshme matematikore. Pyetjes së pyetëtorit se sa i përdorin mësuesit këto mjete mësimore 85% e mësuesve janë përgjigjur pozitivisht. Matematika në ciklin e ulët përfshin edhe kuptime si që janë trupat gjeometrike të cilat më mire spiegehohen me ndihmën e modeleve gjeometrike. Nga mësuesit e anketuar 84% e tyre i përdorin modelet gjeometrike si mjete mësimore. Mësimdhënia është e suksesshme nëse vjen në shprehje krativiteti i mësuesit. Kreativitet dhe gadishmëri për të krijuar mjete mësimore për orën mësimore nga lënda e matematikës janë deklaruar 77% e mësuesve. Mësuesi është në gjendje të krijojë mjete mësimore nga letra, druri, plastika ose edhe ambalazhet e ndryshme mjete për ta bërë orën e matematikës më konkrete, më tërheqëse dhe më kuptueshme për nxënësit. Kjo është e mundur nëse mësuesi është një profesionist i mire, mësuesi është kreativ dhe nëse mësuesi është person që e don profesionin e tij.

Mësuesit e ciklit të ulët në programën mësimore nga lënda e matematikës e kanë pjesën e llogaritjes së numrave duke zbatuar operacionet si që janë mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi. Duke u bazuar në kurrikulën dhe mësimdhënien bashkëkohore në klasat më të larta munden si mjet mësimor ta përdorin kalkulatorin. Pas përpunimit të kësaj pyetjeje të pyetëtorit se sa e përdorin mësuesit kalkulatorin në orën e matematikës 73% prej tyre janë përgjigjur negativisht.

Shekulli XXI është sfida e mësuesit, sepse ai/ajo duhet të adaptohet me kohën dhe ti përcjellë arritjet në mësimdhënie. Mësimdhënia bashkëkohore si mjet mësimor sygjeron kompjuterin për shkak të mundësive që i ofron ai. Pyetja e rradhës e pyetëtorit ishte se sa prej mësuesve e përdorin kompjuterin si mjet mësimor. Nga përgjigjet 87% e mësuesve kompjuterin e përdorin si mjet mësimor. Mësimdhënia bashkëkohore kërkon në klasë të ketë interaktivitet, bashkëpunim, këmbim idesh, ndarje rolesh. Sa është interaktiviteti prezent në klasat e mësuesve pjesëmarrës në anketim e jep tabela e mëposhtëm:

Tab.1. Interaktiviteti në klasë

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja kumulative
Aspak	3	2.6	2.6	2.6
Shumë pak	10	8.8	8.8	11.4
Pak	20	17.5	17.5	28.9
Shumica	55	48.2	48.2	77.2
Të gjithë	26	22.8	22.8	100
Total	114	100	100	

Sipas tabelës një numër i madhë i nxënësve marrin pjesë në mënyrë aktive në orët e matematikës: 48% nga numri i mësuesve janë shprehur që shumica e nxënësve marrin pjesë në mënyrë aktive në orën mësimore, ndërsa vetëm 3% janë shprehur se aspak nuk ka aktivitet nga ana e nxënësve në orën e matematikës. 17% e mësuesve kanë deklaruar se në orën e matematikës ka pak aktivitet, ndërsa 23% e mësuesve janë shprehur se të gjithë nxënësit janë aktiv.

Mësuesi i shekullit XXI luam rolim e lehtësuesit dhe ndërmjetësuesit, e jo rolin e burimit të vetëm të informative dhe dijes. Në këtë kontekst në pyetëtor është parashtruar pyetja se sa nxënësit marrin pjesë me idetë e tyre në orët

mësimore për zgjidhjen e problemeve. Nga gjithsejt 114 mësues 7% përqind e tyre janë deklaruar se nxënësit shumë pak marrin pjesë me idetë e tyre, 40% janë deklaruar se numri është i vogël i nxënësve që marrin pjesë në mënyrë aktive me idetë e tyre në orët mësimore, 34% e mësuesve janë shprehur se në klasat e tyre një numër i madhë i nxënësve marrin pjesë aktive me idetë e tyre në zgjidhjen e problemeve në orët e matematikës.

Me anë të pyetësorit është kërkuar mendimi i mësuesve se si do të mundej të rritet aktiviteti (suksesi) i nxënësve në lëndën e matematikës. Përgjigjet e mësuesve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tab.2. Opinioni i mësuesve si mund të rritet aktiviteti (suksesi) i nxënësve

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja kumulative
Nxënësit të jenë më të pregaditur	22	19.3	19.3	19.3
Prindërit të punojnë më shumë	16	14	14	33.3
Materiali të thjeshtohet	65	57	57	90.4
Shkollat ti përmirësojnë kushtet	11	9.6	9.6	100
Totali	114	100	100	

Nga tabela shihet 65 mësues ose 57% mendojnë që aktiviteti do të rritej poqese materiali do të thjeshtohet, ndërsa 19% mendojnë se nxënësit duhet të vijnë më të pregaditur në shkollë dhe 14% janë të mendimit se prindërit duhet të punojnë më tepër me fëmijët e tyre. Nga të dhënat e paraqitura më lartë mund të vërehet që materiali mësimor në lëndën e matematikës sipas mendimit të mësuesve është shkak për suksesin dhe aktivitetin e ulët të nxënësve në lëndën e matematikës.

Shkollat e shekullit XXI janë shkolla për të gjithë. Nëpër shkollat janë të përfshirë në mënyrë të barabartë të gjithë nxënësit; duke pasur parasysh gjininë, përkatësinë etnike dhe fetare si dhe aftësitë psiko-fizike. Sipas deklarimeve të mësuesve 27% prej tyre në klasë kanë fëmijë me nevoja të veçanta. Për të punuar me këtë pjesë të shoqërisë sonë duhet aftësim i veçant. Gjysma nga numri i përgjithshëm i mësuesve të përfshirë në pyetësor janë të aftësuar për të punuar me nxënës me nevoja të veçanta. Mësuesit kanë qëndrime të ndryshme në lidhje me pyetjen se a duhet nxënësit me nevoja të veçanta të përfshihen në shkollat e rregullta. Nga numri i përgjithshëm 30% e tyre mendojnë se duhet të përfshihen, 59% e mësuesve janë të mendimit se ky lloj i nxënësve nuk duhet të përfshihen në shkollat e rregullta. Pjesa tjetër janë deklaruar se nuk janë në dijeni se a duhet të përfshihen nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta. Mbetet të hulumtohet pse mësuesit, cili është shkak që numër i vogël i mësuesve janë të mendimit se nxënësit me nevoja të veçanta duhet të përfshihen në shkollat e rregullta.

Në këtë studim përveç përpunimit të pyetësorit të realizuar me mësuesit kam formuluar këto hipoteza:

H₀₁: Qëndrimi i mësuesve për rritjen e aktivitetit-suksesit të nxënësve nuk mvaret nga gjinia e mësuesit, përvoja e mësuesit ose tipit të shkollës ku punon

H_{a1}: : Qëndrimi i mësuesve për rritjen e aktivitetit-suksesit të nxënësve mvaret nga gjinia e mësuesit, përvoja e mësuesit ose tipit të shkollës ku punon.

H₀₂: Qëndrimi i mësuesve për përfshirjen e të gjithë nxënësve nuk mvaret nga gjinia e mësuesit, përvoja e mësuesit ose tipit të shkollës ku punon.

H_{a2}: Qëndrimi i mësuesve për përfshirjen e të gjithë nxënësve mvaret nga gjinia e mësuesit, përvoja e mësuesit ose tipit të shkollës ku punon.

Nga tabela më poshtë ku është paraqitur vlera e koeficientit të korelacionit (Pearsonit) shihet që variablat si gjinia e mësuesit, përvoja e mësuesit, tipi i shkollës ku punon mësuesi, qëndrimi i mësuesve se si mund të rritet aktiviteti-suksesi i nxënësve në lëndën e matematikës,, si dhe qëndrimi i mësuesve në lidhje me inkluzionin (përfshirjen) e të gjithë nxënësve në shkollat e rregullta nuk janë në mvarshmëri ndërmjet vedi.

Nga kjo mund të përfundojmë që hipoteza **H₀₁** dhe hipoteza **H₀₂** pranohen , ndërsa hipotezat **H_{a1}** dhe **H_{a2}** bien poshtë (signifikanca 0.05)

Tab.3 Tabela e korelacionit

		Gjinia	Tipi ishollë	Përvoja	interaktiviteti	inkluzioni
Gjinia	Pearson Correlation	1	-0.049	-0.134	0.034	.203*
	Sig. (2-tailed)		0.602	0.157	0.719	0.03
	N	114	114	114	114	114
Tipi i shkolles	Pearson Correlation	0.049	1	-0.104	0.017	0.033
	Sig. (2-tailed)	0.602		0.273	0.856	0.726
	N	114	114	114	114	114

Prrvoja	Pearson Correlation	0.134	-0.104	1	-0.075	-0.011
	Sig. (2-tailed)	0.157	0.273		0.428	0.905
	N	114	114	114	114	114
Interaktiviteti-suksesi	Pearson Correlation	0.034	0.017	-0.075	1	-0.109
	Sig. (2-tailed)	0.719	0.856	0.428		0.248
	N	114	114	114	114	114
Inkluzion	Pearson Correlation	.203*	0.033	-0.011	-0.109	1
	Sig. (2-tailed)	0.03	0.726	0.905	0.248	
	N	114	114	114	114	114
*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).						

3. PËRFUNDIMI

Nga të dhënat e mbledhura dhe përpunimi statistik i tyre, arrijmë në përfundim se shumica e mësuesve të anketuar përdorin mjete mësimore të llojllojshme për ta sqaruar dhe konkretizuar njësinë mësimore nga lënda e matematikës..Gjithashtu vijmë në përfundim që kompjuteri përdoret si mjet mësimi nga ana e këtyre mësuesve.që d.m.th mësuesit janë të pregaditur për punën me kompjuterë. Në bazë të rezultateve të fituara të pyetësorit shumica e mësuesve të anketar kanë shprehur mendimin se materiali nga lënda e matematikës duhet të thjeshtohet me qëllim të rritjes së aktivitetit dhe suksesit të nxënësve nga lënda e matematikës. Në bazë të rezultateve të anketës, 50% e mësuesve janë të aftësuar të punojnë me nxënës me nevoja të veçanta, mirëpo shumica e tyre nuk janë të gatshëm të punojnë me këtë lloj të nxënësve. Ky studim gjithashtu ka vërtetuar hipotezën se nuk janë në korrelacion ndërmjet vedi ndryshoret si gjinia e mësueve, me tipin e shkollës ku punojnë mësuesit, përvoja që kanë mësuesit, qëndrimi e mësuesve në lidhje me rritjen e interaktivitetit (suksesit) të nxënësve në matematikë dhe qëndrimi i mësuesve në lidhje me përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta.

4. PROPOZIM

Nga ky studim, nga të dhënat e mbledhura dhe të dhënat e përpunuara me qëllim që procesi i edukimit në lëndën e matematikës të jetë më i suksesshëm propozoj kurrikula në lëndën e matematikës dhe në lëndët tjera të përpilohet nga gjithë personat të cilët njohin fëmijën e moshës 7-14 vjeç. Me këtë kuptoj që kurrikulën duhet ta përpilojë ekipi i formuar nga pedagogë, mësues, ekspert të fushave përkatëse (në këtë rast matematikan), psikolog, sociolog. Gjithashtu para aplikimit të kurrikulave të reja paraprakisht duhet mësuesit të pregaditen dhe të aftësohen për zbatimin e kurrikulave të reja, sepse në këtë mënyrë mund të tejkalohen dhe eliminohen pengesat dhe problemet eventuale. Kurrikulat dhe ndryshimet e tyre kërkojnë edhe mjete mësimore të reja, mjete mësimore përkatëse me të cilat duhet të furnizohen shkollat, mësuesit dhe nxënësit para se të fillojë zbatimi i kurrikulës së re. Në shumë shtete praktikohet që tekstet mësimore të jenë të dedikuara për nxënësit veç dhe për mësuesit veç. Kjo praktikë duhet të aplikohet edhe tek ne. Prandaj propozoj që të përpilohen tekste për mësuesit, të cilët tekste do të jenë në ndihmë të mësuesve gjatë pregaditjes së tyre për orën mësimore.Pregaditja dhe aftësimi profesional i mësuesve të jetë i vazhdueshëm dhe të realizohet nga persona kompetentë.

REFERENCA

- [1] I.Aksoy.N (1998) “ Opinions of Upper Elementary Students about a "Good Teacher" (Case Study in Turkey Paper presented at the29th Annual Meeting of Northeastern Educational Research Association (Ellenville, New York, October 28-30, 1998))
- [2] 2.Anu Pietilä (2003) FULFILLING THE CRITERIA FOR A GOOD MATHEMATICS TEACHER - THE CASE OF ONE STUDENT-EUROPEAN RESEARCH IN MATHEMATICS EDUCATION III.
- [3] 3.R.M. Harden (2009) “ What is a spiral curriculum?Journal Medical Teacher, Volume 21,1999-Issue2
- [4] 4.Jelli Ann Resurreccion, Jonathan Adanza(2015)” Spiral Progression Approach in Teaching Science in Selected Private and Public Schools in Cavite” DLSU Research Congress 2015,Google scholar
- [5] 5. Judith Howard,(2007), “Curriculum Development” Center for the Advancement of Teaching and Learning- Elon University, Google scholar

- [6] 6. Johnston, Howard (2012), “The Spiral Curriculum. Research into Practice”Institute of Education Research
- [7] 7.Musai.B(2003) “Metodologji e mësimdhënies”
- [8] 8.Miller.P (2012) “Ten characteristics of a Good Teacher”Reflection, Number 1. English teaching forum
- [9] 9.Soledad A. Ulep ”SPIRAL PROGRESSION in the K + 12 MATHEMATICS CURRICULUM” UP NISMED